



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me datë **29.03.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 13, të vitit 2020, në ngarkim të të pandehurve **Ilir Beqaj, Klodian Rjepaj, Ilir Rrapaj, Marsela Serjani, Saimir Kadiu, Petref Mersini, Arben Gjata, Genc Burazeri dhe Naile Ajazi (Abazi)**”.

2. Në seancën e datës **23.01.2025** (seanca paraprake), Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtare Flojera Davidhi, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, me vendimin Nr. **13**, datë **23.01.2025**, vendosi:

- I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- II. Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 13, të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të të pandehurve:
 1. **Ilir Beqaj**, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “*Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën*”, kryer në bashkëpunim të posaçëm, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 135, 28/4 e 334/1 të Kodit Penal; “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a/1 të Kodit Penal;
 2. **Klodian Rjepaj**, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “*Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën*”, kryer në bashkëpunim të posaçëm, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 135, 28/4 e 334/1 të Kodit Penal; “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a/1 të Kodit Penal, dhe “*Falsifikimi i dokumenteve*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/3 e 25 të Kodit Penal;
 3. **Ilir Rrapaj**, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “*Vjedhjes*”, me pasojë të rëndë, e kryer në bashkëpunim të posaçëm, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 134, paragrafi tretë dhe 28/4 e 334/1 të Kodit Penal; “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a/1 të Kodit Penal;
 4. **Marsela Serjani**, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “*Falsifikimit të dokumentave*” kryer në bashkëpunim dhe “*Shpërdorimit të detyrës*” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal;

5. **Saimir Kadiu**, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “*Falsifikimit të dokumentave*” kryer në bashkëpunim dhe “*Shpërdorimit të detyrës*” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal;
6. **Petref Mersini**, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “*Falsifikimit të dokumentave*” kryer në bashkëpunim dhe “*Shpërdorimit të detyrës*” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal;
7. **Arben Gjata**, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “*Falsifikimit të dokumentave*” kryer në bashkëpunim dhe “*Shpërdorimit të detyrës*” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal;
8. **Genc Burazeri**, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “*Falsifikimit të dokumentave*” kryer në bashkëpunim dhe “*Shpërdorimit të detyrës*” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal;
9. **Naile Ajazi (Abazi)**, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “*Falsifikimit të dokumentave*” kryer në bashkëpunim dhe “*Shpërdorimit të detyrës*” kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 186/3 – 25 dhe 248 - 25 të Kodit Penal, trupit gjykues të themelit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë.

- III. Së bashku me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për dërgimin e çështjes në gjyq, dërgohet edhe kërkesa e të pandehurve **Klodian Rjepaj, Ilir Rrapaj, Marsela Serjani, Saimir Kadiu, Petref Mersini, Arben Gjata, Genc Burazeri dhe Naile Ajazi (Abazi)**, për gjykim të shkurtuar.
- IV. Fashikulli i gjykimit përmban të gjitha aktet e kryera gjatë hetimit paraprak të procedimit penal nr. 13, të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si dhe ato të marra në seancë paraprake, të paraqitura nga të pandehurit dhe mbrojtësit.
- V. Kundër vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq nuk lejohet ankim.

Tiranë, më datë 23.01.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar